

Disa risi të projektligjit për procedurat e falimentimit në Shqipëri

1. Hyrje

Grupi i punës në përgatitjen e projektligjit për procedurat e falimentimit mori parasysh:

- Studimin mbi gjendjen ekzistuese dhe gjetjet përkatëse nga grupi i ekspertëve shqiptarë;
- Mendimet e aktorëve dhe institucioneve të përfshira në procedurat e falimentimit, mbi shkaqet dhe vështirësitë e zbatimit të ligjit ekzistues;
- Studimin mbi praktikën juridike dhe rastet e analizuara për të cilat është vendosur hapja e procedurave të falimentimit, pezullimi i tyre, përfundimi i tyre apo rezultatet e tyre;
- Studimin në treg dhe vështirësitë financiare nga këndvështrimi i bizneseve dhe bankave, sikurse edhe ekzekutimi i detyrueshëm nëpërmjet autoriteteve zbatuese etj.;
- Analizën krahasuese të ligjeve aktuale të falimentimit, në veçanti: Ligji amerikan Kapitulli 11, bazuar në të cilin u konsiderua një model për nënkapitull me përkufizime dhe koncepte; ligji italian nga i cili u mor si model nënkapitulli për ristrukturimin e borxhit përmes një marrëveshjeje jashtëgjyqësore; ligji gjerman për falimentimin nga i cili u morën në konsideratë ndryshimet e bëra pas vitit 2012, pasi legjislacioni ekzistues bazohet në legjislacionin gjerman; ligji i vendeve të rajonit si psh. Serbi dhe Mal i Zi.
- Mendime, komente dhe sugjerime të ekspertëve ndërkombëtarë.

2. Risi në terminologji dhe përkufizime

Projektligji i ri i falimentimit përfshin terminologji të përmirësuar dhe një nënkapitull që ka të bëjë me përkufizimet, pasi u kërkua nga përfaqësues të institucioneve dhe nga palë të përfshira në procedurat e falimentimit. Kështu, parashikohen rreth 40 përkufizime të termave si: kredi, kredi e masës së falimentimit, kreditor i rangjeve më të ulëta, administratori i falimentimit, administratori monitorues, familje bujqësore, etj.

3. Risi që kanë të bëjnë me subjektet e falimentimit

3.1 Projektligji parashikon zgjerimin e rrethit të entiteteve, të prekura nga falimentimi, përfshirë: personat natyrorë (si psh. individë, konsumatorë apo persona fizik tregtarë); persona juridikë (si psh. persona juridik, privat dhe publik, fitimprurës dhe jo-fitimprurës); sikurse edhe njësi vendore administrative.

3.2 Në lidhje me rrethin e aktiviteteve me interes për publikun, projektligji parashikon që këto entitete do t'i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të falimentimit kur falimentimi rregullohet nga ligje të veçanta, duke mbetur në këtë pikë brenda kuadrit të parashikuar në ligjin ekzistues. Ndërsa projektligji parashikon që kjo rregullore prek entitete që operojnë vetëm në interesin publik për aq kohë sa ata janë të liçencuar për të kryer aktivitete të tilla. Paraqitet gjithashtu si risi në projektligj, që nëse ligje të veçanta që rregullojnë sektorin publik apo strategjik nuk parashikojnë rregulla falimentimi, atëhere çdo subjekt sipas paragrafit të parë të këtij neni ka të drejtë të kërkojë hapjen e procedurave të falimentimit, vetëm pas marrjes së lejes nga autoriteti përkatës rregullator. Gjithashtu, projektligji parashikon që si anëtarë të komitetit të kreditorëve mund të emërohen gjithashtu njerëz që nuk janë kreditorë, por përfaqësues të një autoriteti rregullator në raste kur debitori kryen aktivitete në sektorin e interesit publik i cili kontrollohet prej tij.

3.3. Lidhur me kompetencën e gjykatës, janë sqaruar fuqitë vendimmarrëse dhe procedurat e gjykatës, duke e bërë ndërhyrjen e gjykatës nëpërmjet vendimeve apo urdhërave të saj më fleksibël dhe të shpejtë vetëm nëpërmjet konsultimeve të bazuara në akte, pa pasur nevojën për një seancë të detyrueshme dëgjimore.

4. Risi që kanë lidhje me subjektet mbikqyrëse

4.1 Projektligji sugjeron që rrethi i subjekteve mbikqyrëse që kanë të drejtë të mirëinformohen rreth procedurave të falimentimit, mbetet jo vetëm në kuadër të Agjencisë së Falimentimit, Gjykatës së Falimentimit, Administratortit të Falimentit, apo Kujdestarit (sikurse është në ligjin ekzistues), por zgjerohet me rolin e Prokurorisë, Kontrollit të Lartë të Shtetit apo roli i Autoriteteve Mbikëqyrëse të sektorëve të ndryshëm në interesin publik. Roli i këtyre subjekteve ka të bëjë me marrjen e informacionit apo verifikimin e dokumenteve, vendimeve të gjykatave, planit të riorganizimit, të ristrukturimit të borxhit apo të transfertave të tre viteve të fundit të subjektit përpara falimentimit.

Kjo synon shmangien e abuzimeve dhe mashtrimeve në procedurat e falimentimit. Projektligji parashikon që "... pas marrjes së një kopje të vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit, prokurori, për të shmangur abuzimin dhe mashtrimin me procedurat e falimentimit, verifikon transfertat dhe veprimet ligjore që kanë lidhje me pasuritë e debitorit dhe personave që kanë lidhje me të, të kryera të paktën gjatë tre viteve të fundit përpara hapjes së procedurave të falimentimit". Grupi i Punës kërkoi një konfirmim për përfshirjen e subjekteve të tilla si të prokurorisë dhe Agjencisë Kombëtare të Falimentimit (AKF) në monitorim.

4.2 Një çështje e rëndësishme për diskutim është ajo që ka të bëjë me rolin dhe statusin e AKF, limitet e pushtetit dhe modeli për t'u ndjekur. Roli dhe pozicioni i AKF duhet të merret parasysh pasi lidhet ngushtë me mundësinë për zgjerimin e gamës së kontrollit dhe subjekteve mbikëqyrëse, aktorëve të rinj të përfshirë të cilët do të kontrollojnë me kujdes jo vetëm procedurën e falimentimit, por do të mbikëqyrin në veçanti raste që kanë të bëjnë me abuzim dhe mashtrim në falimentim. Një kompetencë e re parashikuar në projektligj për FSA është se "... Agjencia kërkon të paktën çdo 3 muaj raportim nga administratori i falimentimit, një kopje të të cilit ia dërgon gjykatës së falimentimit".

5. Risi në lidhje me kostot dhe shpenzimet e falimentimit

Ligji ekzistues parashikon mbylljen apo mos fillimin e procedurave të falimentimit dhe anulimin e detyrimeve të debitorit, i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit. Kjo marrëveshje krijon mundësi të mëdha për skema mashtrimi përmes falimentimit. Grupi i punës kërkoi për të gjetur një zgjidhje që do të shmangte dështimin e procedurave të falimentimit, për shkak të paaftësisë paguese të debitorit.

Projektligji parashikon një mundësi për financim publik që do të drejtohet nga AKF, i cili synon shmangien e bllokimit të procedurave për shkak të dorëheqjes së administratorit apo refuzimit të detyrës prej tij. Parashikimi i riskut të falimentimit që nga fillimi i një aktiviteti tregtar nuk e shmang atë krejtësisht, por e bën më realist. Duke qenë se nga pikëpamja ekonomike, i një biznesi i duhen të paktën tre vite për të kuptuar nëse është duke operuar me sukses apo jo, projektligji i lejon subjekteve tregtare të shikojnë që nëse kurba e tyre e fitimit po shkon drejt shifrave pozitive pas tre vitesh, ata duhet që në këtë moment të krijojnë depozitën e lartpërmendur. Përndryshe, ata mund të vazhdojnë me likuidimin kur të dalin në përfundimin që nuk janë të suksesshëm, pa çuar gjendjen e tyre financiare drejt falimentimit.

6. Risi që kanë lidhje me rolin dhe statusin e administratorit dhe agjencisë

6.1 Në lidhje me administratorin, projektligji ka parashikuar si një zhvillim të ri sqarimin e personave të cilët marrin role mbikëqyrëse gjatë procedurave të falimentimit. Projektligji parashikon tre lloje administratorësh: Administratori i falimentimit, administratori i përkohshëm i falimentimit dhe administratori mbikëqyrës, të cilët kanë të njëtin status dhe të njëjtat kritere përzgjedhjeje, por të cilët marrin role sipas afat kohor gjatë të cilit ata janë aktivë apo sipas specifikimeve të rolit që ata luajnë.

6.2 Në lidhje me trajtimin e administratorit, projektligji parashikon në mënyrë inovatore ndarjen e shpërblimit të administratorit në dy pjesë: administratori i falimentimit ka të drejtën e një rroge mujore, sikurse edhe të drejtën për shpërblim me një përqindje të sasisë së borxheve të zgjidhura nga masa e falimentimit sikurse edhe rimbursim për shpenzimet e bëra gjatë kryerjes së detyrës. Sasia e shpërblimit llogaritet në përfundim të procedurave për falimentim. Niveli i pagës mujore llogaritet në varësi të volumit dhe shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit. Rregulla të detajuara në lidhje me rrogat, kushtet dhe kriteret për përcaktimin e shumës së shpërblimit dhe rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit, vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Secili administrator i falimentimit është i detyruar të kryejë falas që paktën një procedurë në çdo tre vite.

Kjo ndarje është krijuar për të motivuar administratorët në përmbushjen e detyrave të tyre për të maksimizuar masën e falimentimit.

6.3 Gjithashtu, projektligji parashikon një garanci të re për përmbushjen e detyrës së administratorit, duke sanksionuar që administratori i falimentimit, përpara se të pajiset me licencë, të depozitojë në formën e një garancie një shumë të caktuar parash. Shuma e depozituar përcaktohet nga Agjencia Kombëtare e Falimentimit.

6.4 Përveç rolit të administratorit të falimentimit, projektligji parashikon rolin e një kujdestari të trashëgimisë apo ekzekutuesit të falimentimit të cilët njihen dhe parashikohen gjithashtu jashtë procedurave të falimentimit nga Kodi Civil.

7. Risi në lidhje me koordinimin e procedurave të ligjit për falimentimin me ligjin për procedurat tatimore.

Projektligji përcakton se nga pikëpamja procedurale, ligji i falimentimit do të preferohet si i vetmi ligj që rregullon këtë procedurë në raport me ligjin me për

procedurat tatimore. Prandaj, nëse kjo zgjidhje do të mbështetet nga politikëbërësit, ligji mbi procedurat tatimore (Neni 104) do të ndryshohet/shfuqizohet pas hyrjes në fuqi të ligjit të falimentimit.

8. Në lidhje me ristrukturimin e borxhit përmes një marrëveshje jashtëgjyqësore për t'u miratuar nga gjykata

Projektligji parashikon një sërë dispozitash që parashikojnë riorganizimin së bashku me ristrukturimin e borxhit si pjesë e një marrëveshjeje jashtëgjyqësore përmes zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, duke arritur një marrëveshje që duhet të miratohet nga gjykata.

9. Në lidhje me radhën e preferimit

Për herë të parë në historinë e legjislacionit të falimentimit, e cila u adoptua pas viteve '90, në projektligjin e ri ka disa parashikime që ofrojnë një renditje të veçantë preferenciale në lidhje me ripagesën e detyrimeve përpara dhe pas shpërndarjes.

Një ndryshim thelbësor në projektligjin e ri të falimentimit ka të bëjë me parashikimin e një renditjeje të qartë dhe të parashikueshme të përparësive në linjë me kontekstin modern të Shqipërisë. Për këtë arsye, projektligji parashikon detyrimin që përpara fillimit të trajtimit të pretendimeve të kreditorëve sipas renditjes preferenciale, fillimisht duke veçuar shpenzimet për procedurën e falimentimit. Më pas, në projektligj është shtuar një nen i ri me një renditje preferenciale në të cilin është parashikuar rendi i ndarjes së pasurisë, duke filluar me pretendimet e siguruara deri në vlerën e pronësisë që shërben si kolateral. Më pas, listohen pretendimet për përparësi, duke përfshirë: (i) pretendime të ngritura nga përfundimi i punësimit për një periudhë 3-mujore përpara datës së aplikimit të pretendimit apo datës së mbylljes së biznesit, për listën e pagave, duke përfshirë lejet vjetore dhe lejet për arsye shëndetësore, por jo më shumë se 500 mijë Lek në total; financime të marra në formën e një huaje; (ii) pretendime për mos shlyerje të detyrimeve për shpenzime për ushqim kur debitori është individ; (iii) pretendimet e punëmarrësit për dëmtim të jetës dhe shëndetit të shkaktuar gjatë kohës së kryerjes së punës për debitorin, sikurse edhe dëmtime të të njëjtin lloj të personave të tretë si rezultat e veprimeve të jashtëligjshme të debitorit; (iv) pretendime për taksa të pashlyera për një periudhë një-vjeçare përpara aplikimit; (v) shpërblimi i administratorit të falimentimit; (vi) kostot e riorganizimit; (vii) pretendimet e pasiguruara, përveç atyre të rankut më të ulët; (viii) pretendimet e rangjeve më të ulëta dhe pretendimet e ortakëve, aksionerëve, themeluesve, anëtarëve. Grupi i Punës ka nevojë për një konfirmim të kësaj politike propozuar në projektligj.

10. Risi në lidhje me penalitetet

Përsa i përket penaliteteve, projektligji parashikon ekskluzivisht se në rast të abuzimit të procedurave të falimentimit, do të ketë përgjegjësi administrative, ndërsa ato penale duhet të parashikohen vetëm në Kodin Penal.

Shkelje administrative parashikohen në raste të deklaratave me përmbajtje të rremë; fshehje, transferim apo tjetërsim të pronës apo dokumenteve ndaj administratorit të falimentimit apo urdhërit të gjykatës për parandalim të procedurave për falimentim; moszbatim të urdhërave të gjykatës nga administratorët; refuzim nga ana e administratorëve të falimentimit për të dorëzuar asetet dhe dokumentacionin përkatës kur ai shkarkohet nga detyra.

11. Risi në lidhje me paaftësinë për të paguar në planin ndërkufitar

Përsa i përket falimentimit ndërkufitar, projektligji parashikon përfshirjen e një kapitulli të veçantë me objektivin strategjik të adoptimit të Ligjit Model të UNCITRAL mbi Proçedurat e Falimentimit Ndërkufitar pasi kjo do të dërgonte një sinjal të fortë kredibiliteti tek investitorët e huaj në kërkim të niveleve më të larta të parashikueshmërisë në sistemin shqiptar të falimentimit.

12.

Për të shmangur pezullime dhe refuzime të procedurave të falimentimit për shkak të mos mbulimit të kostove, rekomandohet një zgjerim i konceptit të shpenzimeve gjyqësore, duke përfshirë: shpenzimet e gjykatës; rroga e administratorit; shpenzimet e komitetit të kreditorëve, shpenzimet operative të administratorit; detyrimet sipas kontratave dypalëshe, për t'u paguar pas hapjes së falimentimit sikurse edhe detyrime që rrjedhin nga pasurimi i padrejtë.

13. Komunikimi elektronik

Projektligji parashikon për komunikime të shpejta midis palëve të ndryshme të interesuara (p.sh., Gjykata e Falimentimit dhe Agjencia e Falimentimit) të përfshijë gjithashtu edhe komunikimin elektronik. Gjithashtu, entitetet bankare, ZRPP, QKR, etj., janë të detyruara t'i paraqesin administratorit të falimentimit të dhënat përkatëse dhe dokumentet që kanë të bëjnë me veprimet ligjore të debitorit.

14. Konvertimi i rastit

Secili kreditor ka të drejtë të kërkojë konvertim të procedurës për shkak të: paaftësisë për të paguar detyrimet në maturim; njoftimit të administratorit mbikëqyrës mbi paaftësinë e debitorit për të zbatuar planin.

Gjykata e Falimentimit me kërkesë të administratorit mbikëqyrës apo bazuar në ankesën e kreditorëve, pasi ka dëgjuar debitorin vendos konvertimin e procedurave të riorganizimit në likuidim. Kundrejt këtij vendimi të ndërmjetëm mund të paraqitet një ankesë e veçantë në Gjykatën e Apelit.

15. Proçesi i ekspertizës

Huazuar nga K.Pr Administrative, paraqitet koncepti vijues: eksperti i palëve apo gjykata, dhe se ka vetëm një seancë që paraqet raportin apo aktin. Gjatë hetimit gjyqësor, gjykata e falimentimit mund të marrë si provë mendimin e ekspertit të palës së përfshirë dhe/apo të ekspertit të emëruar nga gjykata e falimentimit.

16. Propozime për ndryshime të akteve të tjera ligjore

Duke marrë parasysh problemet e çregjistrimit të subjekteve sipas Ligjit nr. 129/2014 MBI DISA NDRYSHIME TË LIGJIT NR. 9901/2008 MBI KOMPANITË TREGTARE. Nenet 43/99/187/5 të cilat mundësojnë "*shpërbërjen e kompanisë, në rast të pamjaftueshmërisë së aseteve për të mbuluar kostot e procedurave të falimentimit, vendosur nga gjykata e falimentimit kur... gjykata vendos të refuzojë kërkesën për hapjen e procedurave të falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së aseteve të kompanisë për të mbuluar kostot e procedurës së falimentimit*", parashikohet vetëm ndërprerja e procedurave të falimentimit përmes pezullimit, në rast se masa e falimentimit është e pamjaftueshme për të mbuluar kostot.

Procedurat rifillojnë pasi gjenden fondet e mjaftueshme për të mbuluar kostot përmes fondit të veçantë publik apo nga financimi i aktorëve të interesuar.